



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Për:	<b>Smajl Latifi</b> , Kryetar i Komunës së Rahovecit <b>Fatmir Iska</b> , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<b>Elbert Krasniqi</b> , Ministër i MAPL-së <b>Jeton Qela</b> , Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	<b>Erblin Hetemi</b> , Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 23.04.2026 VI- 020-239
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	<b>Xhevat Tafa</b> , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	<b>Donjeta Cakolli</b> , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Konfirmim i Ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin nr.01/128, për dhënien e pëlqimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik deri në 40(dyzet) vite për ushtrimin e veprimtarisë biznesore përmes procedurës së shprehjes së interesit

I miratuar më datë: 24.03.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.03.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

## ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.03.2026, ka miratuar vendimin nr.01/128, për dhënien e pëlqimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik deri në 40(dyzet) vite për ushtrimin e veprimtarisë biznesore përmes procedurës së shprehjes së interesit.

MAPL, konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, është bazuar në nenin 12, paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 5, nenin 6, paragrafi 1, pika 1.2 nenin 8, paragrafi 1 pika 1.2, neni 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimi është miratuar me 14 vota për, 10 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Smajl Latifi, gradonačelnik opštine Orahovac Fatmir Iska, predsedavajući Skupštine opštine Orahovac
Cc::	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,
Od:	Erblin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja /MALS Dana, 23.04.2026 VI-020-239
Odgovorni službenici:	
1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika
2.Službenik/ca za izradu pravne ocene	Donjeta Cakolli, viša službenica za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika
Predmet:	Potvrda zakonitosti
Vrsta odluke:	Odluka

Poštovani/a gradonačelniče/e,

Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa članom 8 i 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom (VRK) br. 03/2026, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026, o oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kao u nastavku:

Odluka br. 01-128 o davanju saglasnosti na razvoj postupka putem otvorenog konkursa za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine, fizičkim i pravnim licima do 40 (četrdeset) godina, za obavljanje poslovnih aktivnosti putem postupaka izražavanja interesa.

Usvojena dana, 24.03.2026.god

Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 31.03.2026.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt je proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi, i kao takav može proizvesti pravna dejstva.

## Obrazloženje

Skupština opštine Orahovac je na sednici održanoj dana, 24.03.2026.godine, odobrila Odluku br. 01-128 o davanju saglasnosti na razvoj postupka putem otvorenog konkursa za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine, fizičkim i pravnim licima do 40 (četrdeset) godina, za obavljanje poslovnih aktivnosti putem postupaka izražavanja interesa.

MALS konstatuje da je doneti akt od strane Skupština opštine Orahovac, zasnovan na članu 12, stav 2, Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 5, članu 6, stav 1, tačka 1.2, članu 8, stav 1 tačka 1.2, članu 8, stavovi 1 tačka 1.2, članu 14 stav 1 i 3 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine.

Odluka je usvojena sa 14 glasova za, 10 protiv i 0 uzdržanih glasa.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.